

MIRATOHET
DREJTORIA E RAJONIT QËNDËR LINDJE KORÇË
DREJTORI
ARDIT MELE

RELACION TEKNIK
(PROJEKT ME PËRSHKRIM)

Mirëmbajtje me performancë : Libonik – Lozhan - Molla Grabove (kufi Gramsh) .
L= 53.1 km (Kontrata Nr 5)

Segmentet që mbulon kontrata

Nr.rrugës	Emërtimi i rrugës	Koordinatat e fillimit	Koordinatat e mbarimit	Gjatësia (km)	Gjerësia (ml)
71	Libonik-Lozhan	N 40°42'57.5" E 20°42'34.4"		15.3	6
71	Lozhan-K/Strelcë			5	6
71	K/Strelcë- Moglice - Kufi Gramsh		N 40°45'02.3" E 20°20'02.6"	32.8	6
SHUMA TOTALE E KONTRATËS Nr 5				53.1	

2.Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga

Segmenti rrugor : Libonik – Lozhan. L = 15.3 km

Kjo rrugë lidh qytetin e Korçës me Hidrocentralin e Moglicës dhe më pas me qytetin e Gramshit dhe ate të Elbasanit. Pjese e aksit nacional qe lidh zonat e Korçës me ato te Gramshit , si aks lidhes midis qarkut Korçe dhe Qarkut Elbasan.

Është rrugë me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Pjesa e pare e ketij segmenti K/Libonik me pike fillimi kryqezimin me rrugen Sh 3 Korçe – Pogradec dhe pike mbarimi qyteti Maliq me gjatesi 1.4 km eshte rruge e mire.

Shtresat asfaltike jane ne gjendje te mire .


Ky segment ka nevojë te vazhdueshme per mirembajtjee ne elemetet e rruges si dhe te sinjalistikes rrugore.

Pjesa e dyte e ketij segmenti nga qyteti Maliq deri ne qender Lozhan deri ne km 15.30 eshte rruge ne investim. Ne kete pjese te aksit rrugor po realizohet investimi per rikonstruksionin e plote te tij, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Edhe pas realizimit te ketij investimi ky segment ka nevojë per mirembajtje te vazhdueshme si rutine edhe dimerore per specifikat e tij.

Rruga është në terren fushor dhe kodrinor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit te mirembajtjes eshte “i mirë”.



Segmenti rrugor : Lozhan – K/Strelcë. L = 5.3 km

Kjo rrugë është vazhdimi i segmentit Libonik – Lozhan dhe lidh qytetin e Korçës me Hidrocentralin e Moglicës dhe me pas me qytetin e Gramshit dhe atë të Elbasanit.

Është me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Ne kete pjese te aksit rrugor po realizohet investimi per rikonstruksionin e plote te tij, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, nga qender Lozhani deri ne K/Strelce, nga km 15.300- 20.30, atje ku fillon rruga e re e HEC Moglica.

Edhe pas realizimit te ketij investimi ky segment ka nevoje per mirembajtje te vazhdueshme si rutine edhe dimerore per specifikat e tij.

E veçanta e tij eshte renia e vazhdueshme e materjaleve ne rruge nga skarpatet anesore te malit qe kalon pergjate rruges ne anen e djathte te saj.

Rruga është në terren fushor dhe kodrinor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit te mirembajtjes eshte “i mirë”.



Segmenti rrugor :K/Strelcë – Moglice - Kufi Gramsh. L= 32.8 km

Kjo rrugë është vazhdimi i segmentit K/Libonik – Lozhan – K/Strelcë dhe lidh qytetin e Korçës me Hidrocentralin e Moglicës dhe me pas me qytetin e Gramshit dhe atë të Elbasanit , si aks lidhes midis Qarkut Korçe dhe Qarkut Elbasan.

Rruga është ndërtuar e re në vitet 2015 - 2018 në zbatim të investimit për ndërtimin e Hidrocentralin të Moglicës mbi lumin Devoll.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Kilometri i parë i këtij segmenti është problematik. Rruga nga km 0+000 deri në km 1+100 është tejte e ngushtë, me kthesa të padukshme dhe pjerrësi që arrijnë deri në 16%.

Rruga ka bankina çakulli të alternuara me kuneta betoni shoqëruar me bordure.

Shtresat asfaltike janë në gjendje të mirë, përjashto këtu vendet me demtime dhe çedime, të cilat janë të evidentuar përgjatë rrugës.

Kanalet dhe kunetat paraqesin problematike të perseritur pasi kanë nevojë për pastrime të vazhdueshme sidomos në periudhën e shirave pasi shpatet anësore sjellin aluvione dhe mund të bllokojnë funksionimin e kanaleve, kunetave dhe tombinove..

Tombinot jane ne gjendje te mire por kane nevojë per pastrime te herepashershme.
Urat pergjithesisht jane ne gjendje te mire por duhen monitoruar vazhdimisht.
Rruga nuk ka permytje por ka rreshkitje te shumta te shpateve anesore.

E veçanta e kesaj rruge eshte prezenca e disa perrenjve malore te thate dhe teper problematike ne ditet me reshje shiu pasi sjellin ujerra dhe materjate te shumta te ngurta.

Kalimi i tyre terthor rruges behet mbi struktura betoni ne forme lugu ne rruge.

Muret mbajtese dhe pritese jane relativisht te mira me perjashtim te disa mureve me gabiona qe kerkojne monnitorim dhe mirembajtje

Gjendja e sinjalistikes eshte e mire por ka nevojë per te shtuar dhe zvendesuar tabelat dhe pervijueset anesore , me qellim rritjen e sigurise rrugore..

Vijeziimi eshte ne gjendje te mire por ka nevojë per rifreskim te vazhdueshem.

Barrierat mbrojtese kane nevojë per rifreskim per shkak te demtimit nga aksidentet dhe kompletim me reflektore barriere.Ne disa vende eshte e nevojshme vendosja e barrierave te reja metalike.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme dhe te vazhdueshem

Ne segmentin K/Strelce- Molle Grabove (kufi Gramsh) theksojme se fundmi jane kryer disa punime rehabilitimi.

Probleme specifike


Ne pergjithesi rruga kalon ne formacione te dobeta dherash ku ka dhe prani te ujrave nentokesore gje qe ka shkaktuar shume cedime te trupit te rruges.

Çedimet ne pjesen me te madhe jane te paasfaltuara dhe ndodhen nga km 1+000 deri ne km 10+000 si dhe nga km 17+000 deri ne km 20+000. Nje pjese tyre duhet te trajtohen me paketa asfaltike te plota me shtresa çakull+binder+asfalt.

Ne nje pjese tjeter duhet te behen studime gjeologjike per te saktësuar asrsyen e demtimit te trupi te rruges dhe menyren e nderhyrjes per rikonstruksion e trupit te rruges per nje karexhate te re , ne sherbim te qarkullimit normal te mjeteve.

Nga km 25+000 deri ne km 30+700 rruga kalon ne formacion shkembor (ultrabazik) i mbrojtur ne pjesen e sipërme me rrjeta konstruktive te cillat kane nevojë per pastrim te vazhdueshem.

Rruga është në terren kodrinor malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore
Niveli i kërkuar i shërbimit te mirembajtjes eshte “i mirë”.





GRUPI I PUNES